



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:014792

Datë: 30.06.2024

Numri i dokumentit: 05876826

KPPP.nr.740/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit TEB SH.A., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Debt Loan Recovery L.L.C, me adresë në rr. “Enver Maloku” Nr. 108, në Prishtinë, kundër debitorëve: 1. “DPH Lounge Bar New Age”, me seli në Fshatin Shallic, në Vushtrri dhe 2. A.K., me numër personal ..., me adresë në Fshatin ..., në Vushtrri, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.226/2022 të datës 21.12.2022, të Përmbartuesit Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “DPH Lounge Bar New Age” dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.226/2022 i datës 21.12.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Driton Govori, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.226/2022 të datës 21.12.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartimore – Kontrata e kredisë me nr. 25720 të datës 26.12.2012, Marrëveshja mbitërheqjen nr. 25720, Lista e pengut të datës 24.12.2012 dhe Regjistrimi i pengut me nr. R-20221220-463 të datës 20.12.2022, me të cilin janë urdhëruar debitorët që kreditorit t’ia paguajnë borxhin në shumë prej 4,233.19 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të urdhrit, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, ashtuqë përmbartimi të realizohet me sekuestrimin e kolateralit të lënë peng sipas listës së pengut të datës

24.12.2012, si dhe me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorëve në të gjitha bankat komerciale, me bartjen e mjeteve financiare nga llogaria e debitorëve në llogarinë e veçantë të përmbaruesit privat nga e cila pastaj do të barten në llogarinë e kreditorit.

Debitori “DPH Lounge Bar New Age” në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se marrëveshja mbi kredinë e datës 26.12.2012 nuk është dokument i besueshëm dhe rrjedhimisht nuk ka titull përmbarimor. Ka shtuar se borxhi i marrë ka qenë në emër të firmës “DPH Lounge Bar New Age” e cila ka falimentuar para tetë vitesh dhe që nga ajo kohë nuk ekziston më. Më tutje ka theksuar se nga koha e marrjes së detyrimit për përmbushje e deri më tani kërkesa është parashkruar e drejta e kreditorit për këtë borxh në kuptim të nenit 354 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD). Gjykatës i ka propozuar që propozimin e kreditorit ta hedhë poshtë si të palejuar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke deklaruar ndër të tjerash se propozimi i kreditorit bazohet në dokumentin përmbarues, përkatësisht në marrëveshjen mbi pengun. Në lidhje me pretendimin e debitorit se obligimi është krijuar para dhjetë viteve dhe se kërkesa është parashkruar dhe se nga ajo kohë nuk ka kontakt mes palëve, e njëjta nuk qëndron, pasi që debitorët janë kontaktuar vazhdimisht për realizimin e obligimit, e që dëshmohet edhe me pagesën e pjesshme të obligimit nga debitorit të paraqitura edhe nga qarkullimi i llogarisë së bashkëngjitur si provë, ku në pajtim me nenin 368 të LMD-së janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore rreth ndërprerjes së parashkrimit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të vazhdohet procedura përmbarimore ndaj debitorit deri në përmbushjen e tërësishme të obligimit, si dhe shumën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorëve është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Sipas nenit 22 par.1 të LPP-së, janë përcaktuar dokumentet përmbarese ndërsa me par.1 nën par. 1.7. të këtij neni, si dokument përmbarese përcaktohet: “...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...” dhe me nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarese përcaktohet se dokument përmbarese paraqet: “...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”, ndërsa me nenin 36 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: “Së bashku me propozimin për përmbarese, organit përmbarese i dorëzohet edhe dokumenti përmbarese, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbareshmërisë për përmbareshmëri”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat, gjeti se Kontrata e kredisë me nr. 25720 të datës 26.12.2012, Marrëveshja mbitërheqjen nr. 25720, Lista e pengut të datës 24.12.2012 dhe Regjistrimi i pengut me nr. R-20221220-463 të datës 20.12.2022, në bazë të së cilave është mbështetur propozimi për përmbarese dhe është lejuar urdhri përmbarese janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 36 të LPP-së.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbarese mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmbarese të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopje e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbarese, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1 të LPP-së: “Propozimi për përmbarese duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarese në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarese origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: “...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbareshmërisë së nxjerrë nga përmbarese privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbaresemit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarese privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarese nga përmbarese privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret Urdhri mbi lejimin e përmbaresemit P.nr.226/2022 i datës 21.12.2022, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarese nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e

dokumenteve përmbarimore dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim, ndërsa organi përmbarues - përmbaruesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbarimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.740/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.